



Prishtinë, 15 nëntor 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1074\_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, dhe Nenit 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafet 1.19 dhe 1.51, Nenit 5, Nenit 33 paragrafi 4, Nenit 39 dhe 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitave të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit;
- Dispozitat e Nenit 19 të Licencës për Furnizim me Energji Elektrike dhënë "KESC" J.S.C;
- Vendimit të ZRRE V\_976\_2018 të datës 13.04.2018 për Hapjen e Procedurës së Tenderimit për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit;
- Vendimit të ZRRE V\_977\_2018 të datës 13 Qershor 2018 për Caktimin (përkohësisht) e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit;

në seancën e mbajtur më 15 Nëntor 2018 nxori këtë:

## V E N D I M PËR CAKTIMIN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT

- I. **Caktohet "KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" (KESC) J.S.C** që të ushtrojë përgjegjësitë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (Furnizues i Garantuar).
- II. Obligimi i caktuar në paragrafin I të këtij Vendimi do të ushtrohet për një periudhë prej tri (3) vitesh, dhe do fillojë të zbatohet nga data 14 Dhjetor 2018 deri më datën 13 Dhjetor 2021.
- III. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është i obliguar që të sigurojë të gjitha shërbimet e furnizimit të përcaktuara me Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit dhe Licencën për Furnizim me energji elektrike të lëshuar nga ZRRE.
- IV. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është i obliguar që të furnizojë konsumatorët që ngelin pa furnizues në rastet kur:
  - furnizuesi i tij ka bankrotuar apo është në likuidim;
  - licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, apo i ka skaduar;


- konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.

- V. Furnizimi i garantuar sipas pikës IV nuk mund të zgjasë më shumë se **gjashtëdhjetë (60) ditë**.
- VI. Kostot e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të përcaktohen në përputhje me Nenin 6 të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit.

## **ARSYETIM**

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në përputhje me dispozitat e Nenit 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike, me Vendimi V\_910\_2017, me datë 13 prill 2017 ka bërë shpalljen e Tenderit për të zgjedhur Furnizuesin të cilit do i ngarkohet obligimi i Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
  2. Në tenderin e shpallur të ZRRE nuk ka aplikuar askush nga Furnizuesit aktual, dhe rrjedhimisht ZRRE nuk ka pranuar asnjë aplikacion nga Furnizuesit aktual të licencuar për ti ushtruar këto përgjegjësi.
  3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 28 prill 2018 me Vendimi V\_976\_2018, ka përsëritur shpalljen e Tenderit për të zgjedhur Furnizuesin i cili do ushtronte përgjegjësitë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
  4. Në përputhje me Nenin 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike, ZRRE me Vendimin \_977\_2018 të datës 13.06.2018 ka caktuar “KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY” (KESC) J.S.C, që PËRKOHËSISHT për një periudhë gjashtë (6) mujore, të ushtronte obligimet e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (Furnizues i Garantuar).
  5. Pasi që ZRRE edhe në Tenderin e dytë të shpallur, nuk ka pranuar asnjë aplikacion nga asnjë Furnizues aktual të licencuar për ta ushtruar këto detyrime, dhe pasi që afati i përkohshëm gjashtë (6) mujor i dhënë me Vendimin \_977\_2018 do skadojë me 13 dhjetor 2018, dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitivin e këtij Vendimi.
- VII. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
  - VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Bordi i Rregullatorit:**



Arsim Janova, u.d. Kryesues



Besim Sejfiqaj, Anëtar



Selman Hoti, Anëtar



Izet Rushiti, Anëtar

**Vendimi i dërgohet:**

“KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY” (KESC) J.S.C,  
Aktivit të Rregullatorit